

Termtat & Kushtet

1. Qëllimi & Pajtimi me Kushtet
2. Fushështirirja
3. Termtat
4. Sendet e Ndaluarat
5. Paketimi & Etiketimi
6. Përmasat dhe kufizimet e dërgesave
7. Marrja e dërgesës
8. Transporti dhe rrugëtimi
9. Dorëzimi i dërgesës
10. Shërbimet & Tarifat
11. Ankesat
12. Mënyrat e pagesës
13. Sigurimi i të dërgesave
14. Rrethanat përtej Kontrollit të APD
15. Garanci & Dëmshpërblim
16. Konfidencialiteti
17. Ligji

1. Qëllimi & Pajtimi me Kushtet

Këto termta & kushte të publikuara nga Albanian Parcel Distribution shpk, përcaktojnë rrethanat e ndërveprimit midis kompanisë në vetvehte, dërguesit, dhe marrësit. Është përgjegjësia e klientit të lexojë e të bjerë dakord me këto kushte të paraqitura para nënshkrimit të kontratës ose gjatë vizitimit të faqes online të APD.

Albanian Parcel Distribution ka si qëllim të kryej shpërndarje në mënyrë korekte duke u nisur nga dërguesi e deri tek marrësi. Raportimi ndodh kundrejt palës kontraktuese, dhe jo tek pala e tretë marrëse. Pavarësisht, APD kontaktohet nga pala dërguese, kjo e fundit paraqet nevojat e saj dhe detajet mbi shpërndarjen në fjalë. Më pas APD krijon kontakt me personin e autorizuar për dorëzim, për të konfirmuar prezencën e një marrësi. Pasi shpërndarja është kryer, APD raporton të gjitha detajet mbi shpërndarjen tek pala dërguese.

2. Fushështirirja



ALBANIAN PARCEL DISTRIBUTION

Këto kushte dhe terma të përgjithshme zbatohen për të gjitha marrëveshjet, kuotimet ose urdhrat që kanë të bëjnë me transportin e dokumenteve dhe mallrave, të lidhura ndërmjet korrierit dhe klientit, duke përfshirë çdo shërbim tjetër shtesë ndërmjet dy palëve.

Çdo devijim nga këto terma dhe kushte, në të cilat mbështetet njëra prej palëve, është e vlefshme vetëm nëse është përcaktuar me shkrim ose është pranuar nga të dy palët.

Këto kushte kanë përparësi mbi të gjitha kushtet e tjera; në rast të kushteve kontradiktore të bashkë-kontraktorit, këto të fundit konsiderohen si jo të shkruara. Kushtet e APD do të zbatohen për të gjitha citimet dhe ofertat e bëra nga APD, të gjitha detyrat e dhëna nga APD, të gjitha marrëveshjet e përfunduara ose në të cilat APD është palë.

3. Termat

Person i autorizuar për dorëzim: Personi i cili është përmendur si marrës nga pala dërguese, dhe rezulton në adresën e paracaktuar për shpërndarje.

Albanian Parcel Distribution: Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar, me emer tregtar Albanian Parcel Distribution, me zyrat qendrore pranë Rr. "Karl Gega", e njohur më poshtë edhe si ("Shoqëria, Ne, ose APD")

#: +355688777757, @: info@apd.al

Adresa e grumbullimit: Adresa e dërguesit prej nga do të mblidhen dërgesat.

Adresa e marrjes: Adresa e përcaktuar nga klienti për të tërhequr dërgesën nga ana e APD me qëllim shpërndarjen në destinacion.

-Adresa e dorëzimit- Adresa fizike në të cilën është kërkuar dorëzimi i dërgesës nga ana e klientit

-Dërgesa: Dokumente/mallra ose një grup sendesh, të cilat transportohen njëkohësisht dhe që janë të destinuara për një marrës.

Forca madhore: Ndodhi natyrore ose jo, te cilat janë jashtë kontrollit të njerëzve

Kuti Postare: Janë kutitë metalike që gjenden në rrugë, ku futen zarfe me adresa të mbishkruara për tu dërguar perkatësisht nga korrieri.

Korrieri: APD ose një prej të emëruarve të tij, i cili ka ndërmarrë kundrejt transportuesit të ngarkesës për të transportuar një dërgesë dhe ta dorëzojë atë tek marrësi në mënyrë profesionale, në përputhje me përdorimin e përgjithshëm të pranuar komercial.

-Klienti: Çdo Person fizik ose juridik që i ngarkon APD-së transportin e dërgesës



ALBANIAN PARCEL DISTRIBUTION

-Marrësi: I adresuari ose përfaqësuesi i tij, i cili konsiderohet të jetë i pranishëm në adresën e dërgimit, të cilit korrieri APD duhet të dorëzojë dërgesën.

4. Sendet e ndaluara

Shpërndarja nuk do të pranohet në rast se përmban:

- Kafshë/Pjesë kafshësh
- Shufra (Lingota) Ari dhe Argjendi
- Këmbim Valutor
- Gura të çmuar
- Armë zjarri/Armë
- Eksplozivë dhe Municione
- Mbetje Njerëzore
- Sende të tjera të paligjshme si; Fildishi dhe Lëndët Narkotike
- Bileta lotarie
- Materiale të dëmshme, korrosive, radioaktive
- Lëndë ilegale dhe substanca halucinogjene
- Mbetje spitalore
- Substanca kancerogjene

5. Paketimi & Etiketimi

Dokumenti

Çdo dokument i nisur me postë duhet të jetë i vendosur në zarf të mbyllur dhe shkruar saktë dhe me shkronja kapitale dërguesi, marrësi dhe adresa e plotë e marrësit (nëse ka dhe numër tel)

Paketimi i kolipostave dhe i pakove duhet bërë sipas një standarti të caktuar për të shmangur dëmtime të mallrave për shpërndarje.

Materiali: Materiali I paketimit të kolipostave dhe pakove duhet të jetë I durueshëm, pra duhet përdorur karton I fortë që ti rezistojë transportit nga korrierët. Gjithashtu duhen përdorur kuti të reja, pasi kutitë e vjetra të kartonit e humbin ngurtësinë dhe qëndrueshmërinë e tyre.

Masa: Masa e kutisë se zgjedhur për transport duhet të ketë përmasa të posaçme për sendet që janë brenda. Nëse kutia është më e madhe se c'duhet, ajo do të kolapsojë, nëse është më e vogël se c'duhet kutia do të plasarit. Nuk duhet lënë vend bosh në kuti pasi sendet do të lëvizin brenda kutisë dhe do të perplasen me njëra tjetrën. Vendet boshe mund të mbushen me bukë peshku, gazeta, ose qese. Gjithashtu objektet brenda kutisë duhen mbështjellur individualisht që të mos fërkohen dhe dëmtohen me njëra tjetrën.

Këshillohet të lihen disa centimetra hapësirë e izoluar midis mureve të kutisë dhe sendeve brenda saj.



ALBANIAN PARCEL DISTRIBUTION

Ambalazhimi: Pasi kutia është mbushur sipas dëshirës me objektet për dërgim, ajo duhet mbyllur me kujdes dhe me ngjitëse të durueshme ndaj lëvizjes. Ngjitësit që duhen përdorur janë:

-Ngjitës Polipropileni (Ngjitës plastik ngjyrë kafe)

-Ngjitës Vinyl (Ngjitës elektrik)

-Ngjitës I përforcuar me fibra

Pasi të keni gjetur ngjitësin e duhur, mbyllni veshët e kutisë, dhe ngjitini ato përkatësisht në formë H-je., duke ngjitur dy veshët e mëdhenj për së gjati, pastaj duke venë nga një rryp ngjitës në ekstremitetet e tyre.

6. Përmasat dhe kufizimet e dërgesave

APD merr përsipër shpërndarjen e dërgesave me një peshë jo më të madhe se kg, dhe ku përmasat bruto të dërgesës nuk i kalojnë mm x mm x mm.

7. Marrja e dërgesës

Klienti garanton që përshkrimi, natyra dhe përmbajtja e dërgesës të jenë saktësuar në shënimin e dërgimit ose në dhënie e porosisë, si dhe që të gjitha detajet janë komunikuar në kohën e nevojshme për ekzekutimin e marrëveshjes. Në këtë mënyrë klienti garanton një përshkrim të saktë dhe të plotë të dokumentit ose mallrave që do të dërgohen, si dhe se adresa e grumbullimit dhe dërgimit të specifikuar është e plotë dhe e saktë.

Paketimi i dokumenteve dhe mallrave kryhet nga dërguesi ose të paktën nën përgjegjësinë e tij të plotë.

Paketimi duhet bërë konform rregullave të saktësuar në nenin 4.

Klienti duhet të mbrojë dhe paketojë dokumentet dhe mallrat nga të gjitha rreziqet e transportit, duke marrë parasysh, ndër të tjera, natyrën dhe përmbajtjen, destinacionin dhe veprimet tipike të metodave normale të trajtimit dhe transportit.

Në veçanti, klienti do të sigurojë që përmbajtja ose një pjesë e saj nuk mund të hiqet pa dëmtuar paketimin.

Klienti gjithashtu garanton se dërgesa është në përputhje me të gjitha rregulloret dhe ligjet dhe se ajo shoqërohet me të gjitha lejet e nevojshme.

Në mungesë të kërkesave të përcaktuara në këtë nen, dëmtimet dhe rreziqet e çfarëdo natyre në lidhje me dërgesën janë në kurriz të klientit.

Nëse të dhënat e kërkuara për ekzekutimin e marrëveshjes nuk janë të plota ose nuk i ofrohen në kohë korrierit, APD ruan të drejtën për të pezulluar ekzekutimin e marrëveshjes dhe / ose mund të çojë në kosto shtesë për klientin.



ALBANIAN PARCEL DISTRIBUTION

Korrieri merr dërgesën e dakorduar në vendin dhe kohën e dakorduar, i cili i dorëzohet marrësit nga ndërlidhësi korrieri ose dorëzimi i dërgesës bëhet pranë zyrave të autorizuara të APD.

8. Transporti & Rrugëtimi

Periodhat e përcaktuara të transportit janë indikative, jo-detyruese dhe nuk përfshijnë një detyrim rezultati. APD megjithatë, bën çdo përpjekje për të respektuar dhe për të arritur periodhat normale të transportit sa më shumë që të jetë e mundur.

APD nuk do të jetë në asnjë rast përgjegjës për vonesat në mbledhjen, transportimin ose dërgimin e dërgesës, pavarësisht nga shkaku i një vonese të tillë. Në rast të vonesës, pavarësisht nga shkaku, dërguesi në asnjë rast nuk do të lejohet të ndërpresë marrëveshjen ose të kërkojë ndërprerjen e kontratës, as të ketë të drejtë për ndonjë kompensim apo interes tjetër.

Klienti bie dakort me rastet e devijimit të rrugëtimin të pakos, dhe ndalesat e nevojshme për shkaqe të ndryshme, në rastet kur vazhdon të jetë në limitet e parapërcaktuara kohore.

9. Dorëzimi i dërgesës

Dërgesa do t'i jepet në dorë personit të autorizuar në adresën e lëshimit, ku do të merret edhe një formë konfirmimi se shpërndarja është kryer.

APD do të njoftojë marrësin për shpërndarjen në vijim. Marrësit do t'i ofrohen opsione alternative për shpërndarjen nëse nuk është prezent, si:

- Kryerja e dorëzimit në një ditë tjetër,
- Dorëzim tek një fqinj fizik/juridik,
- Tërheqje pranë zyrave të APD.

10. Shërbimet & Tarifat

Shërbimet postare do të llogariten duke përmblodhur këto tre kushte;

-Lloji I Shërbimit

-Distanca e përshkuar nga adresa e grumbullimit

-Pesha & Madhësia e pakos

Llojet e shërbimeve janë:

- Shërbim **Periodik** (24h) => +0ALL
- Shërbim **Rutinë** (12h) => +50ALL
- Shërbim **Ekspres** (0-3h) => +100ALL



ALBANIAN PARCEL DISTRIBUTION

Tarifat në bazë të distancës:

- Brënda qytetit => ALL
- Ndër qytetas => ALL
- Kosova => euro

Pesha & Madhësia e Pakos:

- <2kg => +0ALL
- mbi 2.1 kg => +50ALL per kg

Për përmasat e dërgesës jashtë normales duhet konsultim me agjentin kontraktor, duke marrë parasysh mundësinë se dërgesa mund të konsiderohet e padërgueshme nga APD për arsye logjistike.

11. Mënyrat e pagesës

Pagesa mund të kryhet nëpërmjet:

- Karte debiti ose krediti në POS- virtuale dhe fizike
- Llogarisë bankare
- Kesh

12. Ankesat

Ankesat rreth APD për dëmtime të dukshme nga shpërndarja duhen bërë me shkrim ose drejt adresë së emailit support@apd.al, brenda 48 orëve pasi APD ka kryer shpërndarjen e dërgesës. Ankesat në lidhje me faturimin duhet të dërgohen me postë ose email brenda një jave nga data e faturës.

Ankesat që vijnë pas afateve të përcaktuara nuk do të trajtohen APD. Në asnjë rast sasia e dëmit nuk mund të zbritet nga klienti nga shpenzimet e transportit dhe transportit që i detyrohet APD. Klienti ka të drejtë të kryejë një anketim për çdo marrëveshje shpërndarjeje, duke ditur që është përfundimtar dhe përmbyllës.

Mospuqja e këtyre kushteve do e bëjë ankesën të jetë e pavlefshme.

13. Sigurimi i dërgesës

APD ofron dhe shërbimin e sigurimit të të mirave të dërguara në rast humbje ose dëmtimi. Dërguesi duhet të bëjë të ditur dëshirën e tij për të siguruar të mirat për dërgim, me shkrim, në momentin kur përpilohen të dhënat për dërgim.

Ky sigurim nuk përfshin rastet e humbjes apo dëmtimit, kur APD nuk është direkt përgjegjës.

14. Rrethanat përtej Kontrollit të APD



ALBANIAN PARCEL DISTRIBUTION

APD nuk mban përgjegjësi për humbje ose dëmtim të mallrave në rrethanat përtej kontrollit të APD. Këto përfshijnë por nuk limitohen me:

- Dëmtime elektrike/magnetike,
- Defekte ose natyrë problematike të pajisjeve,
- Çdo akt i kryer nga personat jo të kontraktuar ose jo të punësuar nga APD,
- Tërmete,
- Stuhi,
- Përmbytje,
- Luftë,
- Embargo,
- Aksidente rrugore,
- Sulme terroriste, luftë civile, trazira civile ose trazira, luftë, kërcënim ose përgatitje për luftë, konflikt të armatosur, vendosje të sanksioneve, embargo ose ndërprerje të marrëdhënieve diplomatike
- Çdo ligj ose ndonjë veprim të ndërmarrë nga një qeveri ose autoritet publik, duke përfshirë pa kufizim imponimin e kufizimeve, kuotave ose ndalimeve të eksportit ose importit ose mos dhënien e një licence ose pëlqimi të nevojshëm
- Çdo konflikt pune ose tregtie, greva, veprim industrial ose mbyllje
- Ndërprerjen e shërbimeve nga entet locale
- APD nuk do të jetë përgjegjës për humbjen e të ardhurave, humbjen e fitimit, humbjen e tregjeve, humbjen e reputacionit, humbjen e konsumatorëve, humbjen e përdorimit, humbjen e një mundësie edhe nëse kemi pasur njohuri se dëmi apo humbje të tilla mund të lindin ose për çdo dëmtim ose humbje të tërthortë, rastësore, speciale ose pasuese, sa herë që lind duke përfshirë pa kufizim shkelje të kushteve, neglizhencë, veprime me paramendim ose mosveprim.

15. Garanci & Dëmshpërblim

Klienti do të deklarojë APD si jo përgjegjës në rastet kur dështon të përputhet me garancitë e mëposhtme:

- Çdo detaj mbi dërgesën është I vërtetë dhe I saktë,
- Dërgesa është e pranueshme sipas pikave 4 dhe 5,
- Përgjegjësia për dëmtimin e sendeve delikate bie mbi klientin.

16. Konfidencialiteti

APD do të mbajë në mënyrë strikte konfidenciale dhe nuk do t'i zbulojë asnjë pale të tretë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, të gjitha ose disa nga informacionet konfidenciale, të cilat mund të jenë komunikuar nga ose në emër të një Pale tjetër, më poshtë të referuara si "Informacioni Konfidencial".

Informacioni konfidencial është si vijon:

- Adresa, mbiemri dhe mbiemri i Klientit



ALBANIAN PARCEL DISTRIBUTION

- Adresa, mbiemri dhe emri i Marrësit të një Dorëzimi të Mallrave, nëse është ndryshe nga Klienti
- Adresa, mbiemri dhe emri i dërguesit të dorëzimit të mallrave, nëse është ndryshe nga Klienti
- Informacione personale të klientëve, dërguesve dhe marrësve të tilla si, datëlindja, vendlindja, nr. Personal, Nr. I telefonit.
- Çdo informacion që mund të lidhet me mallrat e dorëzuara.

APD do të ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshme për t'u pajtuar me këtë pikë, dhe në veçanti do të imponojë këtë konfidencialitet ndaj punonjësve, bashkëpunëtorëve, agjentëve dhe ofruesve të shërbimeve.

Megjithatë, kjo ndërmarrje konfidencialiteti nuk është e zbatueshme për informacionin konfidencial që ka hyrë në domenin publik në kohën e marrjes së tij, ose Informacionin Konfidencial që është në posedim të njërit prej Palëve para marrjes së saj, ose kur një nga Palët autorizon Palën tjetër me shkrim për të shpërndarë informacionin konfidencial.

Nëse një zbulim i Informacionit Konfidencial kërkohet nga ligji në fuqi ose nga një gjykatë ose autoritet rregullator kompetent, Pala e kërkuar duhet, sa më shumë që të jetë e mundur, ta informojë Palën tjetër me shkrim menjëherë përpara se të ndërmarrë këtë zbulim dhe të japë ndihmën e saj për Palën tjetër, nëse e kërkon këtë, për të marrë të gjitha masat mbrojtëse. Shpalosja e informacionit konfidencial në këto rrethana nuk do të jetë shkelje e kësaj pike.

17. Ligji

Në rast ballafaqimi me ligjin, APD do të paraqesë në formë mbrojtjeje, këto Terma & Kushte, duke përmendur faktin se Klienti apo kushdo tjetër i kontraktuar apo jo që ka rënë dakort me këto kushte, mban përgjegjësi mbi veten e tij/saj. Cdo formë mosmarreveshje do të zgjidhet sipas ligjeve në fuqi të Republikës së Shqipërisë, dhe në rast mos arritje marreveshje mes palëve, çështja do të trajtohet në Gjykatën e rrethit Tiranë.